



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 05 Prot.

Lezhë, më 10.08. 2020

**VENDIM**

Nr. 9, datë 07.08 2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES PËR SHFRYTËZIM TË MATERIALEVE INERTE, NJËSIA**  
**ADMINISTRATIVE ZEJMEN, BASHKIA LEZHË, PËR SUBJEKTIN "BARDH**  
**KONSTRUKSION" SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 12, pika 1 neni 44, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre” dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes “ Për shfrytëzim të materialeve inerte” subjektit “BARDH KONSTRUKSION ” SH.P.K. sipas kushteve të mëposhtme:

Shfrytëzimi i materialeve inerte të bëhet me shtresa uniforme dhe jo me gropa me thellësi të ndryshme;

- Të realizohet një pus për monitorimin e nivelit të ujit në tarracën aluviale të lumit Mat, në një pikë të përshtatshme në zonën e shfrytëzimit;
- Të aplikojë për leje hapje pusi dhe autorizim përpara fillimit të zbatimit të kësaj lejeje;
- Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme nivelin e ujërave nëntokësore dhe të përgatisë një raport mujor drejtuar SHGJSH-së dhe ZABU Ishëm – Erzen – Mat;
- Në rastet e prishjes së regjimit sasior dhe cilësor, të cilat vërtetohen se kanë ndodhur nga shfrytëzimi i inerteve, duhet të ndërpriten në mënyrë të menjëhershme punimet e shfrytëzimit të shtratit;

- Në rastin e prishjes së kontratës koncesionare kjo leje është e pavlefshme;
- Materialet inerte të nxjerra në zbatim të kësaj leje nuk lejohet të përdoren për qëllime të tjera përveç objektit të kësaj kontrate;
- Të informohet ZABU Ishëm – Erzen – Mat me listën e përditësuar për çdo muaj për pronësitë e mjeteve që do të punojnë në lumë dhe nënkontratat me mbajtësin e lejes së shfrytëzimit.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

**Anastasi Meci**

